



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 840 Prot.

Tiranë, më 12 . 11 . 2024

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 110, datë 12 . 11 . 2024

“Për fillimin e mbikëqyrjes me objekt monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në lidhje me zbatimin e detyrimit ligjor, të organeve disiplinore, për fillimin e procedimit disiplinor, të kërkuar nga njësitë me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo audit, në institucionet e administratës shtetërore, për vitin 2024”.

Në zbatim të nenit 11, pika 1, dhe nenit 14 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar; të Planit vjetor të veprimtarisë së Komisionerit për vitin 2024, të miratuar me vendimin nr. 106, dt. 15.12.2023, të Komisionerit; si dhe të Rregullores “Për procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit”, miratuar me vendimin nr.17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit civil, të ndryshuar, nisur nga problematika që kanë ngritur organet me kompetenca kontrolli, të brendshëm apo të jashtëm, në lidhje me respektimin e kërkesave të tyre për fillimin e ecursë disiplinore ndaj punonjësve të konstatuar me shkelje disiplinore, gjatë veprimtarisë së tyre,

URDHËROJ:

1. Fillimin e mbikëqyrjes për monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil në institucionet e administratës shtetërore, me objekt: *zbatimin e detyrimit ligjor, që kanë organet disiplinore, për fillimin e procedimit disiplinor, të kërkuar nga njësitë me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo audit, në institucionet e administratës shtetërore, për vitin 2024.*
2. Ky proces do të kryhet nga Inspektorët në përbërje të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, të cilët do ta zhvillojnë këtë proces sipas ndarjes për institucionet e administratës shtetërore në vijim:

8. Me këtë urdhër, duhet të njihen të gjithë inspektorët e ngarkuar për ndjekjen e procesit, duke i vënë në dispozicion një kopje të aktit si dhe programit të mbikëqyrjes.

9. Me zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Mbikëqyrjes dhe Inspektimit; Drejtori i Drejtorisë së Mbikëqyrjes; Drejtori i Inspektimit dhe Hetimit Administrativ; Drejtori i Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese të Komisionerit dhe inspektorët përkatës, sipas pikës 2 të këtij urdhëri, si dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetese, për të mbështetur procesin në drejtim të sigurimit të fondeve përkatëse dhe logjistikës.

10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

